



**BPrAL AAB**  
INSTITUCIONI I ARSIMIT UNIVERSITAR

**Fakulteti / Departamenti:** Fakulteti i Kulturës Fizike dhe Sportit

**Lënda:** Ligjërata # Historiku i zhvillimit të tenisit dhe rekuizitat

Tenisi i sotëm i ka rrënjët nga loja e vjetër franceze e quajtur “paume”, rregullat e së cilës janë shkruar në vitin 1592 në Paris. Anglezi Volter Vingfild është bazuar në këto rregulla kur në vitin 1874 e ka patentuar lojën e tenisit, kurse 25 rregulla të tenisit janë definuar në vitin 1875. Me këtë lojë ai ka shpresuar se do të krijon pasuri. Në fillim Volter Vingfild ka shpikur tenisën i cili është zhvilluar në bari duke i kombinuar elementet e “badmintonit” dhe tenisit të pallateve mbretërore i pagëzuar me emrin “Sphairistrike” (nga greqishtja e vjetër që do të thotë art i lojës me top).

Tenisi në bari shumë shpejtë ka arritur popullaritet, mirëpo ata që kanë luajtur këtë lojë në atë kohë nuk e kanë respektuar emrin e lojës nga greqishtja e vjetër, as patentën e vendosur nga ana e Vingfildit lidhur me dimensionet e fushës së lojës dhe standardin e pajisjeve dhe tre vite më vonë patenta e Vingfildit bie. Kurse kampionati i parë në tenis zhvillohet në vitin 1877 në para lagjen Vimbldon të Londrës.

Kampionatet e para ndërkombëtare janë mbajtur në: SHBA 1881, Australi 1905, dhe Francë 1925. Tenisi është zhvilluar në lojërat e para moderne olimpike në vitin 1896, më vonë në vitin 1928 është tërhequr nga olimpiada për tu rikthyer përsëri në vitin 1988.

Tenisi për një kohë të gjatë ka qenë sport me të cilin janë marr meshkujt e shtresave të pasura të shoqërisë dhe anëtarët e klubeve ekskluzive. Në vitin 1889 asociacioni i tenisit amerikan në bari (USTA, sot asociacioni i tenisit amerikan) nën ombrellën e vet i ka marr edhe femrat me çka tenisi behët njëjtë tërheqës për të dyja gjinitë. Andaj, në konkurrencën e femrave kanë filluar të shkëlqejnë emrat si Suzanne Lenglen, Elizabeth Ryan, Helen Wills Moody, Alice Marble, Helen Jacobs të cilat kështu kanë krijuar numrin e madh të adhuruesve, kurse meshkujt Bill Tilden, Jean René Lacoste, Don Budge duke iu falënderuar lojës së tyre të mirë kanë mbushur kopertinat e revistave të ndryshme.

Prej vitit 1913 për këtë sport përkujdeset federata ndërkombëtare e tenisit në bari, e cila me datën 1977 është shndërruar në Federatën Ndërkombëtare të Tenisit (ITF).

Historia e tenisit në Kosovë i ka rrënjët pas Luftës së Parë Botërore. Atëbotë, britanikët të cilët shfrytëzonin minierën e Trepçës, ndërtuan terrenin e parë të tenisit në Kosovë. Ky terren ekziston edhe sot si dëshmi e kohës, por është i mbuluar me baltë dhe me bar.

Kosovarët për herë të parë filluan të luajnë tenis, në Prishtinë, disa të rinj entuziastë e luanin tenisën edhe pse nuk kishte terrene të mirëfillta, nuk kishte trajnerë, nuk kishte as pajisje të duhura. Krejt çka dinim për tenisën ishte parë vetëm në televizion.

Në kushte të tilla të vështira, me terrene të improvizuara të tenisit, interesimi për tenis, si sport, për çudi, rritej vazhdimisht. Filluan të formohen klube të tenisit, si në Pejë, Prishtinë, Prizren etj.

Federata e Tenisit e Kosovës është formuar në Pejë, në tetorin e vitit 1996. Sot në Kosovë kemi 7 trajnerë të licencuar ndërkombëtarisht nga PTR (Professional Tennis Registry). Federata e Tenisit së Kosovës për shkak të rrethanave të njohura historiko politike ende nuk ka arritur që të jetë anëtare e Asociacionit Evropian të Tenisit (ETA) dhe as Federatës Ndërkombëtare të Tenisit (ITF). Kjo ka bërë që niveli i cilësisë së tenisit dhe infrastrukturës përkatëse të jetë në nivelin e ulët. Tenistët kosovarë edhe sot e kësaj dite nuk kanë të drejtë pjesëmarrjeje në turnetë zyrtarë të ETA dhe ITF.

Rekuizitat për tenis (reketi, topat, veshmbathja) janë të domosdoshme për mbarëvajtjen e lojës së tenisit. Ndër ta reketi është më i rëndësishmi andaj sipas madhësisë së kokës reketët ndahen në: reketët e mëdha, të mesëm dhe të madhësisë standarde, kurse sipas përdorimit të grupmoshave kemi reketët e gjatësisë 43-53cm për fëmijë, 58.5cm 63.5cm 66cm për junior e pionier dhe për senior 68.5cm. Gjatësia e reketit standard i cili më së shumti përdoret është 69cm, kurse pesha e shumicës së reketëve sot është rreth 255-340g. Materialet të cilët më së shumti përdoren për prodhimin e reketëve janë grafiti, aluminium, druri, boron dhe kevlar (shih foton nr. 1).



*foto nr. 1*

Topat për tenis dikur mbaheshin në shportat metalike, nga tri topa në secilin shportë duke u mbyllur me qelës. Sot topat mbahen në shportat plastike. Topi klasik i tenis përbëhet nga goma, me mbështjellës të najlonit i cili quhet <sup>1</sup>“filc” i mbushur me ajër. Trashësia e “filcit” ndihmon që topi të mos këtë shpejtësi shumë të madhe e cili nuk mund të kontrollohet. Sipas trashësisë së filcit kemi trashësinë standarde e cila është më e mirë për palestra, kurse shumë të trasha janë më të përshtatshme për terrenet e forta pasi që më ngadalë e humbin flicin. Deri në vitin 1972 të gjithë topat kishin ngjyrë të bardhë, më vonë shkencëtarët kanë konstatuar se ngjyra e verdh është shumë më e dukshme, sidomos nëse përcillet në ekranet e vogla (TV).

Pajisjet tjera të nevojshme për një teniser të pajisur mirë janë: kapelat, krema për diell, syza të diellit, shiritat nga pambuku për djersitje, peshqiri, “grifat” (shiritat për mbajtjen e dorëzës), çantat për reket, “vibrastop”, mbajtësi për topa.

Literatura:

<http://www.tenniskosova.com/tjetra.php?gjuha=0&category=2>

Siljak, Violeta / Istorija Sporta / Beograd 2007 / Kapitulli VI / faqe 154

McEnro Patrik dhe Bodo Peter / Tenis za Neupucene / Wiley Publishing, Inc / Perktim nga Ilic Milos dhe Iva Cvorovic / faqe 25-42

Brown, Jim / Steps to Success / 2004, 1995 Human Kinetics / Redaktor i përkthimit Sergej M. Ostojic / faqe 9

---

<sup>1</sup> Filc term për mbështjellësin e jashtëm të topit